



REPUBLIKA E SERBIË



Mbrojtësi i qytetarit

## KOMENTARI

MBI ÇËSHTJE TË CAKTUARA TË LIGJIT DHE RREGULLORES ME TË CILAT  
ËSHTË RREGULLUAR POZITA E PAKICAVE KOMBËTARE

*Në raport me zbatimin e konventës Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha  
formave të diskriminimit racor*

Beograd, shkurt 2011.

Duke u nisur nga Raporti i Republikës së Serbisë mbi zbatimin e Konventës ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racor (CERD) në periudhën prej vitit 1992 deri 2008 si dhe raportin për zbatimin e kësaj Konvente të përgatitur nga organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare si: Amnesty International, Roma Right Centar dhe Praxis, CEKOR dhe Qendra regjionale për pakica, Mbrojtësi i qytetarëve sipas kompetencave dhe përvojës së tij vë në pah problemet që janë tregues dhe shkak të pabarazisë së qytetarëve të Serbisë dhe të cilët kërkojnë intervenimin për luftimin dhe mënjanimin e tyre.

Problemet të cilat i vë në pah Mbrojtësi i qytetarëve para Komitetit për zbatimin e CERD kanë të bëjnë me pozitën e pakicave kombëtare (etnike) dhe kushteve të cilat në mungesë të rregullave, moszbatimit të tyre, kapaciteteve të pamjaftueshme të shërbimeve publike i kontribuojnë: mosbarazisë së qytetarëve të pakicave kombëtare, diskriminimit dhe rezistencave shoqërore që disa të drejta të garantuara të implementohen. Shumica e lëshimeve dhe problemeve të cilat i vë në pah Mbrojtësi i qytetarëve, e me të cilat cenohet barazia, gjegjësisht të cilat janë ose mund të jenë shkak i diskriminimit, kanë të bëjnë me periudhën prej se ky organ është formuar—korrikut të vitit 2007. Në lidhje me këtë, pikëpamja e Mbrojtësit të qytetarëve nuk është raporti i tij përfundimtar për zbatimin e CERD por vetëm komentar dhe mendim mbi lëshimet dhe problemet të cilat janë bërë në lidhje me eliminimin e diskriminimit.

1. Raporti shtetëror tregon për gjendjen e mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të pakicave kombëtare në periudhën prej vitit 1992 deri 2008 dhe vë në pah ndryshimet që janë bërë gjatë kësaj periudhe. Përparimi që ka shënuar shteti në lidhje me rregullimin e statusit të pakicave kombëtare dhe mbrojtjes së tyre nga diskriminimi është i dukshëm edhe në fushën e normativave ligjore, rezultatet e të cilit përmbahen në: Kushtetutën e RS-së (2006), Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare (2009), Ligjin për këshillat nacionale të pakicave kombëtare (2009), Ligji për ndalimin e diskriminimit (2009) si dhe rregulloreve dhe ligjeve të shumta të cekura në raportin shtetëror. Gjithashtu janë themeluar organet administrative të cilat kujdesen për zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave, ndërsa në sistemin juridik dhe jetë publike janë themeluar organet e pavarura monitoruese – Komisionari për mbrojtjen e të dhënave të personave dhe informatave të interesit publik, Komisionari për barazi dhe në fund Mbrojtësi i qytetarëve, kurse në nivelin e KA të Vojvodinës edhe Ombudsmani krahinor. Është bërë edhe qasja instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave nacionale dhe janë ripërtërirë mekanizmat e bashkëpunimit të plotë në lidhje me monitorimin e realizimit të drejtave të pakicave në bazë të instrumenteve ndërkombëtare të nënshkruara dhe të ratifikuara më herët, në mesin e të cilave edhe CERD. Këto të dhëna flasin për orientimin e shtetit që të rregullojë pozitën e pakicave nacionale, të mbrojtë të drejtat specifike të tyre dhe të mundësojë barazi të plotë dhe pjesëmarrje në jetë publike.
2. Esenca e mbrojtjes së të drejtave të pakicave është përcaktuar në *Ligjin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare (2002)* i cili në praktikën juridike dhe në jetën publike ka vendosur si vijon:

- Është aprovuar definicioni i hapur i nocionit të pakicave kombëtare e cila është në frymën e Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare të Këshillit të Evropës, e cila përmban kritere objektive dhe subjektive në bazë të cilëve anëtarët e pakicave kombëtare përcaktojnë qëndrimin e vet lidhur me atë se cilës përkatësi etnike (kombëtare) i përkasin. Rrjedhimisht, çdo grup i shtetasve të RS-së e cila në territorin e saj është e pranishme në një numër „reprezentativ“, pjesëtarët e të cilave kanë karakteristika specifike si gjuhë, kulturë, prejardhje etnike, fe në bazë të të cilave dallohen nga shumica dhe dëshirojnë të kujdesen vetë për to, paraqesin pakicë kombëtare (Neni 2. i Ligjit);
  - Është vendosur autonomia kulturore e pakicave kombëtare që nënkupton masa të mbrojtjes speciale të pakicave në ato lëmi që janë të rëndësishme për ruajtjen e identitetit të tyre – shkollimin, kulturën, informimin dhe përdorimin zyrtar të gjuhës (n.9-17);
  - Është vendosur nocioni i vetëqeverisjes së pakicave nëpërmjet këshillit Nacional të pakicave kombëtare (neni 19);
  - Janë vendosur masat e veprimit afirmativ (masa për sigurimin e barazisë së plotë) (neni 4).
3. Me Kushtetutën e Serbisë të vitit 2006, këto të drejta janë inkorporuar në sistemin kushtetues, kurse me miratimin e *Ligjit për këshillat nacionale të pakicave kombëtare (2009)* është synuar të rregullohet pozita e vetëqeverisjes së pakicave, gjegjësisht që të rregullohet mënyra e zgjedhjes së tyre, të përcaktohen kompetencat, të përcaktohen marrëdhëniet e tyre me pushtetin shtetëror, krahinor dhe lokal dhe të zgjidhet mënyra e financimit të autonomisë kulturore.
4. Përkundër përparimit evident, që është i dukshëm në bazë të faktit që në vitin 2010 pas realizimit të zgjedhjeve janë themeluar 19 vetëqeverisje të pakicave, duhet të theksohen edhe problemet e caktuara të cilat janë paraqitur ose mund të paraqiten, e që rrjedhin nga rregulloret e cekura:
- A. Të drejtën në autonomi kulturore dhe rrjedhimisht edhe mbrojtjen e identitetit faktikisht e realizojnë vetëm pakicat kombëtare që i plotësojnë kushtet sipas nenit 2 të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave nacionale (2002) dhe që kanë përzgjedhur vetëqeverisjen e pakicave të vetë përmes së cilës i realizojnë këto të drejta (neni 75, parag. 3 i Kushtetutës së RS-së; neni 2 i Ligjit për këshillat nacionale të pakicave kombëtare). Sipas zgjedhjeve kushtetuese—juridike të drejtën për autonomi kulturore realizojnë pakicat kombëtare që marrin pjesë në zgjedhje të veçanta të organizuara në të cilat zgjedhin vetëqeverisjen e vet të pakicës kombëtare, pas së cilës regjistrohen në regjistrin publik dhe kryejnë kompetencat e përcaktuara me ligj. Përrjashtim nga ky rregull është bërë në rastin e bashkësisë Hebreje sepse me nenin 134 të Ligjit për këshillat nacionale të pakicave kombëtare, pozita e Këshillit Ekzekutiv të Lidhjes së Komunave Hebreje të Serbisë, është barazuar me pozitën e këshillave nacionale: „Këshilli Ekzekutiv i Lidhjes së komunave hebreje të Serbisë kryen funksionin

e këshillit nacional, kurse kryetari i Lidhjes së komunave hebreje të Serbisë është edhe anëtar i Këshillit të Republikës së Serbisë për pakicat nacionale“.

Mbrojtësit të qytetarëve me ankesë i është drejtuar qytetari pjesëtar i komunitetit hebre i cili është ankuar se iu është pamundësuar aftësia për të zgjedhur dhe për të qenë i zgjedhur në vetëqeverisjen e pakicave të Hebrenjve në Serbi. Qytetari ka cekur se pasi që nuk është anëtar i bashkësisë së komunave hebreje, por është anëtar i bashkësisë Hebreje, që nuk ka gjasa që të realizoj të drejtën që të ndikoj ose të merr pjesë në punën e vetëqeverisjes së pakicave të bashkësisë së vetë, e të cilat i realizojnë anëtarët e pakicave të tjera nacionale. Në këtë rast Mbrojtësi i qytetarëve duke pasur parasysh veçantitë e pozitës së pakicës hebreje, i ka tërhequr vërejtje organit kompetent shtetëror për ankesë të qytetarit dhe nuk ka iniciuar procedurë të mëtejme duke pritur që me ndryshimin e Ligjit ky problem do të tejkalohet. Padyshim që e drejta për mbrojtje të identitetit duhet, nën kushte të njëjta, të jetë në dispozicion të gjithëve dhe që secili qytetar që është pjesëtar i ndonjë grupimi etno-kulturor ka të drejtë që në kushte të njëjta me të tjerët të vendos dhe të merr pjesë në ruajtjen e këtij identiteti. Padyshim që edhe në rastin e përmendur ekzistojnë rrethana objektive që vështirësojnë pjesëtarëve të komunitetit hebre që të shmangen nga organizimet tradicionale me të cilat është e organizuar jeta e tyre kulturore dhe fetare. Mirëpo, e gjithë kjo nuk duhet të jetë arsye për përjashtimin e qytetarit prej mënyrave ligjore të ushtrimit të të drejtave. Prandaj, Mbrojtësi i qytetarëve konsideron se me ndryshimin e Ligjit duhet të tentohet në zgjidhje që do të merr në konsideratë rrethanat specifike dhe të drejtën e qytetarëve për barazi.

Në lidhje me këtë, është edhe pyetja – a janë pjesëtarë të pakicave nacionale të cilët për çfarëdo arsye nuk kanë zgjedhë vetëqeverisjen e pakicave, në pozitë të pabarabartë në raport me pjesëtarë të pakicave të tjera nacionale? Në fakt, të drejtën për autonomi kulturore, si dhe të drejtën për mbështetje shtetërore për autonomi kulturore realizojnë vetëm pakicat nacionale të cilat kanë përzgjedhur vetëqeverisjen e pakicave dhe që janë të regjistruar pranë organeve shtetërore gjegjëse, por jo edhe pjesëtarë të pakicave nacionale të cilët këto organe nuk i kanë zgjedhur.

- B. Në lidhje me zgjedhjen e këshillit nacional të pakicave nacionale (vetëqeverisjet e pakicave) Mbrojtësi i qytetarëve në bazë të procedurave që kanë udhëhequr Komisariati për mbrojtjen e barazisë dhe Komisariati për mbrojtjen e të dhënave të personave dhe informatave me rëndësi publike, informatave nga Ministria e punëve të brendshme dhe ankesave të qytetarëve, ka konstatuar se organi shtetëror gjegjës i ngarkuar me organizimin dhe zbatimin e zgjedhjeve të organeve vetëqeverisëse të pakicave, përmes akteve nënligjore ka kontribuar parregullsisht të cilat kanë kushtëzuar keqpërdorime në lidhje me regjistrimin dhe regjistrin e veçantë zgjedhor për zgjedhje të këshillave nacionale të pakicave kombëtare.

Komisionerja për mbrojtjen e barazisë ka konstatuar që organi gjegjës shtetëror, me ndryshimin e Rregullores për konstituimin e këshillit nacional boshnjak, ka shkelur parimin e barazisë dhe solli Rekomandimin përkatës që është zbatuar.

Mbrojtësi i qytetarëve ka sjellë Rekomandimin (16-1725/10) që udhëzon Ministrinë për të drejta njerëzore dhe të pakicave që të fillojnë ndryshimin e Ligjit për këshillat nacionale të pakicave kombëtare që do t'i rregullonte çështjet e regjistrimit në regjistrin e veçantë zgjedhor dhe respektimin e të drejtave për autonomi kulturore.

C. Ligji për këshillat nacionale ka edhe mangësi të tjera të cilat bëjnë që pjesëtarët e pakicave nacionale nuk ndodhen në pozitë faktike të njëjtë në kuadër të sistemit të përbashkët juridik.

C.1. Me Ligj është paraparë që organet vetëqeverisëse të pakicave zgjidhen kryesisht në nivel nacional përmes të cilit është instaluar sistem i fortë centralist gjë që i konvenon homogjenizimit të pakicave nacionale, por edhe segregacionit shoqëror të tyre. Problemi i këtij sistemi është që numri i madh i pjesëtarëve të pakicave nacionale nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën e autonomisë kulturore. Megjithatë, me ligje dhe rregullore është rregulluar që të drejtat e pakicave nacionale realizohen dhe zbatohen në njësitë e vetëqeverisjes lokale, kurse realizimi i të drejtave kulturore të veçanta është fuqimisht e lidhur me numrin e pjesëtarëve të pakicës nacionale që banojnë në territorin e caktuar (e drejta për shkollim realizohet drejtpërdrejtë nëse së paku pesëmbëdhjetë prindër përcaktohen që fëmijë të tyre vijojnë njëri prej mënyrave të shkollimit; të drejtën për përdorim zyrtar të gjuhës dhe alfabetit të pakicave nacionale e realizojnë pjesëtarët e pakicave nacionale të cilët në territorin e njësisë të vetëqeverisjes lokale përbëjnë 15% të banorëve...). Mirëpo, ndikimi i qytetarëve të pakicës nacionale në realizimin e autonomisë kulturore është i kufizuar vetëm në të drejtën që të zgjedhin përfaqësuesin e vet për organin e vetëqeverisjes së pakicave në nivel qendror. Në këtë mënyrë pjesëtarët e pakicave nacionale të shpërndarë (Romët) dhe pjesëtarët e pakicave kombëtare që banojnë jashtë qendrës kulturore tradicionale të pakicave nuk realizojnë dhe nuk mund të ndikojnë as në marrjen e vendimeve dhe as mbi përbërjen e autonomisë kulturore që iu është garantuar me Kushtetutë dhe ligje, as në realizimin e saj në bashkësinë lokale në të cilën jetojnë.

C.2. Neni 71. i Ligjit për këshillat nacionale të pakicave kombëtare rregullon që të drejtën për kandidim në listat zgjedhore në zgjedhjet për këshillat nacionale të pakicave kanë edhe partitë politike të pakicave. Kjo zgjidhje nuk është zbatuar në të drejtën komparative në regjion, kurse zbatimi i saj gjatë zgjedhjeve të para për këshillat nacionale në vitin 2010 dëshmuar se kushtet më të volitshme për realizimin e fushatës dhe zgjedhjes patën pjesëtarët e pakicave që janë anëtar ose përkrahin programin politik të ndonjëris prej partive politike të pakicave. E drejta për organizimin politik të pakicave është legjitime dhe me Ligj për partitë politike (neni 3), është definuar pozita e partive politike të pakicave mirëpo ajo nuk është ngushtë e lidhur me dimensionin etno—kulturore. Në fakt, arsyet për të cilat qytetarët i bashkëngjiten partive politike të pakicave shtrihen më gjerë sesa vetëm mbrojtja e identitetit kulturor por janë të lidhur me bindje ideologjike,

pikëpamjeve ekonomike, sociale dhe çështjeve të tjera me interes për të gjithë qytetarët. Së fundi, të gjithë pjesëtarët e pakicave nuk duhet të ndajnë bindjet dhe idetë politike të njëjta. Mirëpo, shumica e pjesëtarëve të pakicave ndajnë interes të përbashkët dhe brenga për ruajtjen e identitetit dhe duhet të kishin kushte dhe qasje të barabartë për realizimin e kësaj të drejte. Insistimi ligjor në atë që partitë politike të pakicave të jenë bartëse të listave zgjedhore i konvenon grupimeve politike të organizuara të pjesëtarëve të pakicave dhe gjeneron pabarazinë në qasje efektive të të drejtave.

D. Në lidhje me pikën C.2. edhe me Ligjin për zgjedhjen e deputetëve popullor (2006) janë pranuar masat e veprimit afirmativ në bazë të cilave **disa pakica** gëzojnë të drejtën që të marrin pjesë në punën e Kuvendit Popullor. Neni 81 i këtij Ligji mundëson që në ndarjen e mandateve të marrin pjesë edhe partitë politike të pakicave dhe koalicionet e tyre që kanë fituar më pak se 5% të votave nga numri i përgjithshëm i votuesve që kanë votuar. Ndarja e mandateve të tyre përcaktohet në bazë të parimit të pragut natyror, gjegjësisht numri i mandateve „pakicë” përcaktohet në bazë të parimit të koeficientit më të madh (në rastë se për listën e pakicave kanë votuar 30.000 votues, kurse numri mesatar i votave për një mandat për deputet është 15.000 vota, atëherë kjo pakicë kombëtare në Kuvendin Popullor fiton dy mandate). Në bazë të parimit të zbatimit të këtyre masave afirmative në Kuvendin Popullor janë përzgjedhur 4 pjesëtarë të pakicës hungareze, dy pjesëtarë të pakicës Boshnjake dhe një pjesëtarë i pakicës shqiptare. Të gjithë të tjerët, përfshirë edhe Romët, që janë pakicë e konsiderueshme, nuk janë përfshirë në pushtetin ligjvënës. Respektimi i parimit të barazisë dhe eliminimi i dyshimit që masat e veprimit afirmativ nuk janë në dispozicion të gjithë pjesëtarëve të pakicave por vetëm atyre që janë demografikisht të fortë dhe, para se gjithash, politikisht mirë të organizuar, do të arrihej nëqoftëse do të mundësohej që në jetën parlamentare të gjendet mënyra për ndikim efektiv të të gjitha pakicave.

5. Pjesëtarët e pakicave nacionale, që janë banorët e KA të Vojvodinës, gëzojnë shumicën e të drejtave të njohura individuale dhe kolektive. Në këtë pjesë të Serbisë ekziston tradita e njohjes së identitetit të pakicave dhe në këtë bazë edhe mbrojtja e të drejtave të tyre. Në Raportin që ka dorëzuar Republika e Serbisë për zbatimin e CERD, janë cekur të dhëna që tregojnë për shkallën e lartë të realizimit të këtyre të drejtave. Rol të veçantë në lidhje me këtë kanë institucionet e krahinës autonome që përkujdesen, por edhe brengën për gjendjen e multikulturalizmit realizimit dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Sigurisht që ka hapësirë për përparimin e kësaj gjendje dhe propozimet të cilat Mbrojtësi i qytetarëve dhe Ombudsmani i KA të Vojvodinës i kanë dorëzuar në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhës të pakicave tregojnë për një mundësi të përmirësimit.

Në pjesë të tjera të Republikës së Serbisë për fat të keq nuk është gjendja e tillë dhe pjesëtarët e pakicave që banojnë në pjesën qendrore të Serbisë nuk realizojnë në masë të plotë të drejtat e garantuara që realizojnë bashkatdhetarët e tyre ose pjesëtarët e pakicave të tjera në KA të Vojvodinës. Arsye për këtë janë të shumta, kurse Mbrojtësi i

qytetarëve konsideron që përparimi i organizimit dhe punës së qeverive lokale dhe shtetërore mund të kontribuojnë si në realizimin efikas dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave, gjithashtu edhe në eliminimin e çfarëdo pabarazie që drejtpërdrejt mund të shpie deri te paraqitja e racizmit, ksenofobisë apo shovinizmit.

Kapacitete të pazhvilluara të qeverisë shtetërore kanë të bëjnë me: a) mospërcjellje të realizimit të të drejtave; b) mungesë të mekanizmave të kontrollit të zbatimit të ligjit dhe rregulloreve në njësitë e vetëqeverisjes lokale; c) mosharmonizimin e ligjeve dhe rregulloreve me standardet ndërkombëtare, Kushtetutën dhe ndërmjet vetë tyre; d) potenciale të pamjaftueshme kadrovike për realizimin e kompetencave të përcaktuara me Ligj në lidhje me realizimin e të drejtave të pakicave; e) mosrregullimi i financimit të punës së vetëqeverisjes së pakicave të përcaktuara në mënyrë ligjore.

Në lidhje me çështjet e cekura, Mbrojtësi i qytetarëve tregon për tre udhëzime të pazbatuara që i ka përgatitë në bazë të procedurave që ka udhëhequr në bazë të ankesave të qytetarëve dhe vetëqeverisjes së pakicave:

A) **„Rasti Priboj“**: Priboji është komuna multietnike në jugperëndim të Serbisë (Sanxhak) në të cilën përveç shumicës Serbe (68,42%) tradicionalisht jeton edhe pakica boshnjake (22,46%). Sipas Kushtetutës dhe ligjit, pjesëtarët e pakicës boshnjake kanë të drejtë që në përdorim zyrtar në territorin e komunës, të përdorin edhe gjuhën boshnjake. Që këtë të drejtë të shfrytëzojnë, duhet që deputetët në Kuvendin komunal Priboj të votojnë ndryshimin e nenit 5 të Statutit të komunës ashtu që në përdorim zyrtar përveç gjuhës serbe është edhe ajo boshnjake. Edhe pse këshilltarët, qytetarë të nacionalitetit boshnjak, vetëqeverisja e pakicave e tyre dhe partitë politike të pakicave, kanë parashtruar këtë pyetje në rend dite në Kuvendin komunal, këshilltarët tashmë prej një dekade refuzojnë këtë kërkesë ose nuk dëshirojnë të deklarohen për këtë. E drejta legjitime e deputetëve të cilët kanë mandat burimor që lirshëm, sipas vullnetit të vet deklarohen rreth çështjeve për të cilat vendos kuvendi lokal do të ishte në këtë rast argument që nuk bëhet fjalë për të drejtën të rregulluar drejtpërdrejt me Kushtetutën (neni 78) të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave (neni 11. par. 2), të Ligjit për përdorim zyrtar të gjuhës dhe alfabetit (neni 11) dhe Ligjit të vetëqeverisjes lokale (neni 20. par.1 pika 32). Mbrojtësi i qytetarëve me rekomandimin 16-1566/09 (31 mars 2010) udhëzoi pushtetin lokal që të ndërmarrin të gjitha masat që të krijohen të gjitha kushtet për zbatimin e të drejtës në përdorim zyrtar të gjuhës dhe shkrimit boshnjak. Rekomandimi nuk është zbatuar.

Refuzimi shumë vjeçarë i autoriteteve lokale që të zbatojnë Ligjin dhe të harmonizojnë statutin komunal me Kushtetutën dhe ligjin tregon problemin shoqëror thelbësor dhe sjelljen e shumicës ndaj pakicës lokale. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale fqinje ky problem është tejkaluar dhe gjuha boshnjake është në përdorim zyrtar, por jo edhe në Priboj në të cilën mbahet distanca etnike latente por e fuqishme.

B **„Rasti Bratstvo“:** Këshilli nacional i pakicës kombëtare bullgare me ankesë i ka vënë në pah Mbrojtësit të qytetarëve që Ministria e kulturës, pas shumë decenie të sigurimit të financimit të veprimtarisë gazetare e botuese të SHGB „Bratstvo“ në gjuhën bullgare nga buxheti i Republikës së Serbisë, prej vitit 2009 ka ndryshuar mënyrën e financimit dhe mori Vendimin për ndërprerjen e përkrahjes financiare të rregulltë të publikimeve dhe librave në gjuhën bullgare të përcaktuar me ligj. Mbrojtësi i qytetarëve pas zbatimit të procedurës, lëshoi Udhëzimin 16-549/09 në të cilin mori qëndrimin që me shfuqizimin e Ligjit përmes të cilit ishte e rregulluar pozita e shtëpisë botuese „Bratstvo“ dhe prurjes së Vendimit të cekur është rrezikuar shkalla e arritur e të drejtave të pakicës bullgare në lidhje me ruajtjen e traditave dhe identitetit kulturor dhe i ka rekomanduar Ministrisë së kulturës që të respektojë parimin kushtetues të mbrojtjes së të drejtave të fituara, të përcaktojë mënyrën dhe kriteret për bashkëfinancimin e veprimtarisë botuese të SHGB „Bratstvo“. Ky rast ka vënë në pah që pavarësisht mjedisit të njëjtë normativ, ekzistojnë dallime të theksuara në aspektin e realizimit të disa të drejtave të pakicave. Në fakt, në KA të Vojvodinës nga buxheti krahinor në mënyrë të mjaftueshme dhe me rregull financohet veprimtaria botuese e këshillave nacionale të pakicave me seli në këtë pjesë të Serbisë, kurse këshillat nacionale me seli jashtë krahinës, ndër të tjera edhe ai bullgar, financimi realizohet në mënyrë sporadike, kryesisht përmes konkursit në Ministrinë e kulturës.

C **„Rasti i pjesëmarrjes efektive të pakicave kombëtare në kryerjen e punëve publike“:** Me nismën e vet, Mbrojtësi i qytetarëve konstatoi që organet shtetërore nuk zbatojnë Kushtetutën dhe ligjin (Kushtetuta RS, neni 77, par.2; Ligji për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave, neni 21; Ligji për shërbyesit civil, neni 9, par.3; Vendimin e Qeverisë së RS-së mbi masat për rritjen e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në organet e administratë publike („Gaz.zyr.RS”, nr. 40/2006)), zotimeve të përcaktuara në lidhje me punësimin e pjesëtarëve të pakicave në ente dhe administratë shtetërore që kryejnë punë publike, në bazë të së cilës lëshoi Propozimin 45-218/09 me anë të së cilës i drejtohet Shërbimit për udhëheqjen e kadrove të Qeverisë së RS-së që të ndërmerr masat nga kompetencat e saj në mënyrë që të sigurohet zbatimi i kësaj të drejte të pjesëtarëve të pakicave. Mirëpo, edhe pse në ndërkohë është ndryshuar Ligji me anë të të cilit rregullohet pozita e nëpunësve shtetërorë dhe që kanë mundë të ndërmirren masat të cilat do të kishin rritur gjasat e pjesëtarëve të pakicave që në kushte të parapara me ligj të punësohen në shërbimet publike, deri te kjo nuk ka ardhur.

6. Sipas rezultateve të Regjistrimit të popullsisë të vitit (2002) në Serbi jetojnë 108.193 qytetar të nacionalitetit rom. Hulumtimet dhe vlerësimet tregojnë se numri është më i madhë (afro 450.000) dhe që arsye e mospërputhjes në mes të statistikave zyrtare dhe vlerësimeve në shumicën e rasteve është tendenca e Romëve për t’iu shmangur për shkak të diskriminimit dhe paragjyqimeve, gjegjësisht që përparimin shoqëror e sigurojnë më lehtë në qoftë se e fshehin identitetin etnik të tyre.

Problemi themelor i jetës së rëndë të Romëve në Serbi është varfëria strukturore e cila mund të tejkalohet vetëm me mbështetje institucionale dhe masave afatgjate të eliminimit të shkaqeve të kësaj gjendje. Në lidhje me këtë, Kuvendi Popullor ka miratuar Strategjinë e integritit të Romëve (2009), kurse Qeveria e RS-së, përpos që i është bashkangjitur iniciativës regjionale „Dekada Roma“ më 2005 miratoi plane të veprimit për avancimin e pozitës së Romëve në lëmitë e arsimit, banimit, punësimit dhe mbrojtjes shëndetësore, e pesë vjet më vonë edhe tetë plane tjera të veprimit në fusha të ndryshme. Gjithashtu, janë themeluar disa institucione të cilat përkujdesen për zbatimin e Strategjisë dhe planeve të veprimit – Zyra për avancimin e pozitës së Romëve në Ministrinë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, Këshilli i Qeverisë së RS-së për integritimin e Romëve, Zyra për përfshirje të Romëve në Qeverinë e KA të Vojvodinës. Në fillim të vitit 2011, e pamundur është që të përcaktohen të arriturat e programit të Qeverisë në pozitën e gjithëmbarshme të Romëve. Problemi i veçantë në lidhje me këtë është mungesa e informatave të organeve shtetërore për masat e ndërmarra dhe rezultatet e arritura. Informatat ekzistuese më shumë tregojnë dobësitë e programit se sa suksesin e tij.

Në përpjekje që, në harmoni me kompetencat e tij, të analizojë rezultatet e programit shtetëror të Romëve, Mbrojtësi i qytetarëve në bashkëpunim me agjencionet të KB ka hartuar programin e vëzhgimit të rezultateve të arritura dhe zbatimin e Strategjisë dhe planit të veprimit. Rezultati i këtij aktiviteti të Mbrojtësit të qytetarëve do të jetë raporti i Veçantë Kuvendit Popullor për zbatimin e Strategjisë për integritimin e Romëve dhe rekomandime organeve shtetërore gjegjëse në lidhje me avancimin e gjendjes e cila do të konstatohet.

Zgjidhja e problemit të „personave ligjërisht të padukshëm“ gjegjësisht qytetarëve të cilave nuk iu është pranuar statusi dhe të drejtat qytetare sepse asnjëherë nuk janë regjistruar në librat amë dhe nuk kanë dokumente personale me dekada të tëra, është aktivisht i shprehur në punën e organeve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve. Në përpjekje për të kontribuar në zgjidhjen e statusit të njerëzve me statut qytetar të pazgjidhur, në mesin e cilave më së shumti janë Rom, Mbrojtësi i qytetarëve ndërmjetëson në bisedime në Ministrinë e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale në kompetencat e së cilës është zbatimi i organizimit të regjistrimit në librat amë, UNHCHR dhe organizatave joqeveritare në lidhje me zgjidhjen sistemore të statutit të „personave ligjërisht të padukshëm“. Gjithashtu, me ankesa të qytetarëve, Mbrojtësi i qytetarëve vepron, duke iu mundësuar „personave ligjërisht të padukshëm“ që të regjistrohen në librat amë dhe të marrin dokumente personale.

Mbrojtësi i qytetarëve ka filluar edhe me organizimin e pranimit të ankesave të qytetarëve në lagjet e romëve. Kjo ishte e domosdoshme sepse është vërejtur që numri i ankesave të Romëve është në disproporcion më e ulët në krahasim me problemet me të cilat ballafaqohen. Motiv për kësaj lloj organizimi të punës paraqet edhe të kuptuarit se Romëve shumë institucione u janë të pa disponueshme, dhe se ballafaqohen me pengesa të

ndryshme, mes të cilave është i mundshëm edhe diskriminimi, gjatë realizimit të të drejtave njerëzore dhe qytetare.

7. Viteve të fundit është shpeshtuar paraqitja e racizmit dhe ksenofobisë ndaj Romëve, por edhe ndaj pakicave të tjera.

**Rasti Jabuka:** Në qershor të vitit 2010 në fshatin Jabuka, afër Beogradit, Romët kanë qenë të nënshtruar sulmit shumë-ditor të bashkëqytetarëve, Maqedonasve dhe Serbëve etnik (Jabuka është fshati në të cilin, sipas regjistrimit të vitit 2002, banojnë 51% Serbë dhe 32% të pakicës maqedonase dhe 0,38% të pakicës rome). Si arsye e sulmeve në të cilën morën pjesë afro 1000 njerëz ishte zënka e minoreneve që përfundoi me vrasje – një djalosh i nacionalitetit rom gjatë rrahjes vrau bashkëmoshatarin Maqedonas. Intervenimi i policisë, dhe paraburgimi i shpejtë i organizatorëve të sulmit dhe kualifikimi i prokurorisë që është fjala për vepër penale të nxitjes dhe përhapjes së urrejtjes racore, nacionale dhe fetare, aktivitetet e bashkësive të vetëqeverisjes lokale, nuk ishin masa të mjaftueshme për përfundimin e protestave. Mbrojtësi i qytetarëve disa herë, gjatë atyre ditëve vizitoi Jabukën, kurse protestat dhe sulmet janë ndërprerë me apelin e përbashkët të Kryetarit të shtetit dhe Mbrojtësit të qytetarëve, qytetarëve të Jabukës. Mbrojtësi i qytetarëve pas kësaj ka vazhduar të vëzhgojë zhvillimin e situatës dhe vlerëson se edhe më tej është i pranishëm tensioni dhe racizmi latent.

**Shkruarja e grafitëve raciste:** Edhe pse sporadike, por gjithnjë më shpesh në shtëpitë e romëve ose në afërsi të lagjeve të tyre shkruhen grafitë të motivuara raciste, vizatohen dhe dërgohen mesazhe përçmuese dhe kërcënuese. Si shembull, në vitin 2011 Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar procedurën në lidhje me shkrimin e mesazheve të motivuara raciste në lagjet e romëve në Pozhega dhe Sombor. Në këto raste, si dhe në disa të mëhershme, procedura hetimore është kryer, dhe në harmoni me ligjin dhe rregullave hetimore, është iniciuar aktakuza kundër personit N.N. në lidhje me nxitjen dhe urrejtjen nacionale dhe racore. Mirëpo, Mbrojtësi i qytetarëve nuk është në dijeni nëse kryerësit e këtyre veprave penale janë identifikuar dhe a janë gjykuar sipas aktakuzës.

**Protesta gjatë zhvendosjes së romëve:** Për racizmin flasin edhe disa protesta që janë mbajtur në Beograd gjatë tentimit të zhvendosjes së vendbanimeve jo higjienike të romëve. Në fakt, disa herë pushteti i qytetit ka tentuar të zhvendosë banorët e dy vendbanimeve të mëdha rome në Beograd të Ri në lokacione ku me planin urbanistik të qytetit janë paraparë për këtë destinim -- Zemun Polje, Ovqa, në lokacionin tjetër në komunën e Beogradit të Ri. Mirëpo, çdo herë qytetarët që banojnë në afërsi të këtyre lokacioneve kanë protestuar duke treguar haptazi se nuk dëshirojnë që romët e këtyre vendbanimeve të jenë fqinjët e tyre. Mbrojtësi i qytetarëve i ka propozuar pushtetit të qytetit në lidhje me zhvendosjen e Romëve nga lagja „Gazella“ që ka qenë e vendosur poshtë urrës qendrore të qytetit. Romët nga ky lokacion janë zhvendosur në mënyrë të pranueshme, por jo edhe në harmoni me Planin e veprimit për banimin e Romëve të cilin e ka miratuar Qeveria e RS-së dhe standardeve ndërkombëtare. Romët nga kjo lagje janë zhvendosur përkohësisht në kontejnerë në disa lokacione të qytetit. Sipas njohurive të

Mbrojtësit të qytetarëve vjen deri te shqetësimet e kohëpaskohshme të Romëve të banuar në këto lokacione.

**Racizmi ndaj nxënësve romë:** Një shembull i qartë i sjelljes raciste është identifikuar në procedurën të cilën Mbrojtësi i qytetarëve e ka udhëhequr në rastin e vajzës romë të cilën bashkëmoshatarët për shkak të ngjyrës së lëkurës dhe përkatësisë nacionale e kanë ofenduar, përbuzur dhe sulmuar fizikisht. Në vend të përkrahjes, të arsimtarët dhe udhëheqësit e shkollës, familja e kësaj vajze ka pranuar mesazhe që tregojnë në pandjeshmëri dhe racizëm të fshehur.

**Segregacioni i motivuar me paragjykimet racore:** Në lidhje me arsimin në shkolla fillore është vërejtur që prindërit të nacionalitetit jo romë në disa bashkësi lokale gjithnjë më shpesh nuk i regjistrojnë fëmijët në shkolla në të cilat vijon numri i konsiderueshëm i nxënësve Romë. Ky problem është më i theksuar në SHF „Petar Tasiq“ në Leskovc.

*Edhe pse organet udhëheqëse nuk kanë paraqitur të dhëna të sakta dhe precize për atë se në cilën mënyrë Romët ballafaqohen me diskriminimin gjatë shkollimit, punësimit ose realizimit të të drejtave, pasojat e tyre janë të dukshme. Deri tani, me përjashtim të prurjes së Ligjit për ndalimin e diskriminimit (2009), nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash, as nuk janë miratuar aktet ligjore me anë të cilave do të parandalohet diskriminimi i Romëve ose në bazë të cilit do të eliminohej pasojat e saj. Shqetësues është edhe fakti se kryerësit e veprës penale të shkakimit të jotolerancës racore, nacionale, etnike dhe fetare shumë rrallë zbulohen dhe procedohen.*

**Shembuj të jotolerancës ndaj pjesëtarëve të pakicave të tjera kombëtare:** Që me problemin e racizmit dhe intolerancës nacionale ballafaqohen edhe pjesëtarët e pakicave të tjera, tregojnë edhe procedurat të cilat Mbrojtësi i qytetarëve i ka iniciuar. Në Temerin pasi që janë shkruar grafite shoviniste ndaj pjesëtarëve të pakicës hungareze, është nxitur tensioni etnik që kanë shkakuar disa konflikte. Grafiteve raciste i janë nënshtruar edhe pjesëtarët e bashkësisë hebreje, boshnjake dhe të pakicës shqiptare, kurse në fillim të vitit 2011 Mbrojtësi i qytetarëve ka iniciuar procedurën në të cilin konstaton fakte në lidhje me devijimin e organeve shtetërore gjatë ofendimit të rëndë të krenarisë kombëtare të pakicës kroate në Suboticë. Mbrojtësi i qytetarëve ka udhëhequr edhe procedurën ndaj mjekut të punësuar në qendrën Klinike të Serbisë për arsye se pacienten me thyerje e ka përbuzur për shkak të përkatësisë myslimane, e në vijim është procedura e verifikimit a kishte diskriminim në Ministrinë e punëve të brendshme gjatë punësimit të qytetarëve të nacionalitetit boshnjak.

**Diskriminimi në baza fetare:** Diskriminim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë kishte edhe në lidhje me realizimin e lirisë së fetare. Mbrojtësi i qytetarëve ka udhëhequr procedurën në lidhje me keqtrajtimin e qytetarëve pjesëtarë të bashkësisë fetare Hindu Vajshna, gjatë së cilës ka konstatuar që Ministria e punëve të brendshme ka ndërmarrë masa të parapara me ligj, mirëpo edhe që nuk ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të zbulojnë autorët që në mënyrë brutale kanë ofenduar dinjitetin e tij dhe i kanë shkakuar lëndime.

Gjithashtu, kisha ortodokse Rumune tregon për problemin në lidhje me punën e saj në pjesën verilindore të Serbisë qendrore e cila është e banuar me pjesëtarë të pakicës vllehe. Duke mos u zhytur, në problemin e identitetit Vlleh dhe prejardhjes etnike të tyre, që është çështja e përcaktimit subjektiv të qytetarit, Mbrojtësi i qytetarëve është njoftuar me problemin me të cilin ballafaqohen klerikët besimtarë të kishës ortodokse Rumune në këtë pjesë të Serbisë.

8. Ligji për kishat dhe bashkësitë fetare i vitit (2006) është dashur të rregullojë pozitën ligjore të kishave dhe përpunojë parimin kushtetues të lirisë fetare (Kushtetuta e RS-së, neni 43). Në pjesë të caktuara, kjo është përcaktuar me ligj, por kanë mbetur shumë kundërthënie dhe paqartësi të cilat i ka vënë në pah Mbrojtësi i qytetarëve, por edhe bashkësitë fetare të vogla dhe ekspertët. Mbrojtësi i qytetarëve me *Mendimin* (16-1211/09) për nevojën e avancimit të pozitës juridike të kishave dhe bashkësive fetare dhe realizimin e lirive fetare përmes përparimit të rregulloreve dhe zbatimit e drejtë të tyre i vuri në pah Ministrisë së fesë nevojën për realizim më të plotë të të drejtës fetare të garantuar me Kushtetutë dhe të drejtës së kishave dhe bashkësive fetare, gjegjësisht atyre që dëshirojnë që të regjistrohen si të tilla, kërkon avancimin e dispozitave të Ligjit për kisha dhe bashkësive fetare dhe Rregullores për përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit të kishave dhe bashkësive fetare, por edhe avancimin e mënyrës së zbatimit të tyre. Para marrjes së Mendimit Mbrojtësi i qytetarëve me kujdes ka analizuar dhe organizuar debat profesional për përvojat regjionale në lidhje me realizimin e lirive fetare, ka përgatitur analizë profesionale të Ligjit mbi kisha dhe bashkësitë fetare dhe problemeve që paraqiten në zbatimin e tyre. Duke i dërguar Mendimin Ministrisë së fesë, Mbrojtësi i qytetarëve ka pasur parasysh edhe atë që zbatimi i Ligjit dhe mënyra si është rregulluar regjistrimi i kishave dhe bashkësive fetare për pasojë mund të ketë statusin të pabarabartë juridik të kishave dhe bashkësive fetare.

Në këtë aspekt, Mbrojtësi i qytetarëve posaçërisht ka vënë në pah që ndryshimi i amendamenteve të Ligjit mbi kishat dhe bashkësive fetare të cilat gjatë zbatimit kanë shkaktuar vështësi dhe konflikte, do t'i kontribuonin realizimit më të dobishëm dhe efikas të lirive fetare, avancimin e pozitës juridike të kishave dhe bashkësive fetare dhe avancimin e sigurisë juridike. Në këtë aspekt, janë veçuar nenet: 6 (autonomia e kishave dhe bashkësive fetare); (rregulativa autonome e kishave dhe bashkësive fetare); 8 par. 5 (e drejta e klerikëve për pjesëmarrje në jetën publike); 16 (bashkësitë fetare); 18 (procedura e regjistrimit të organizatave fetare); 19 (emërtimi i organizatës fetare); 20. par. 3. dhe 4. (zgjidhja e kërkesës për regjistrim në Regjistr); 22 (fshirja nga Regjistri).

Mbrojtësi i qytetarëve me Mendim ka tërhequr vëmendjen edhe në atë që paqartësia dhe mungesa e bazës Ligjore të numrit më të madh dispozitave të Rregullores mbi përmbajtjen dhe mënyrës së udhëheqjes së Regjistrit të kishave dhe bashkësive fetare („Gaz.Zyrtare e RS-së“, nr. 43/2006) në masë të madhe dëmton pozitën juridike të kishave dhe bashkësive fetare të bazuar në Kushtetutën e RS-së dhe Ligjin për kishat dhe bashkësive fetare. Ministria e religjioneve duhet, me miratimin e ri ose me ndryshime thelbësore të Rregullores

ekzistuese për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të kishave dhe bashkësive fetare, do t'i kontribuonte në mënyrë domethënëse pozitës juridike të kishave dhe bashkësive fetare dhe do të eliminonte numrin më të madh të pengesave në realizimin efikas dhe ligjor të të drejtave të kishave dhe bashkësive fetare gjatë procedurës së regjistrimit.

Më në fund, me Mendim është cekur që përparimi në realizimin e lirive fetare do të ishte realizuar edhe me zbatimin më të drejtë të rregulloreve, para se gjithash në kuptimin e konsistencës më të madhe dhe zbatimit uniform ndaj të gjithëve që gjenden në situatë të njëjtë juridike; interpretimet e rregulloreve në mënyrë e cila për pasojë ka veprim nxitës e jo parandalues në realizimin e lirive fetare dhe mbështetjes së parimit të procedurës administrative.

Mbrojtësi i qytetarëve, **duke vënë në pah**: shembuj të racizmit të hapur apo të mbuluar dhe jotolerancës nacionale; lëshimet në ligj dhe rregullore dhe mos zbatimin e tyre gjë që sjell deri te diskriminimi dhe faktikisht deri te pozita e pabarabartë e pjesëtarëve të pakicave; duke ndërmarrë aktivitete nga kompetencat e tij; **tenton t'i kontribuojë**:

- Tejkalimit të çfarëdo forme të racizmit, shovinizmit dhe diskriminimit;
- Miratimit të rregulloreve zbatimi i të cilave në praktikë mundëson përparim efektiv në lidhje me eliminimin të racizmit dhe shovinizmit dhe përparim faktik të mbrojtjes së të drejtave të pakicave;
- avancimit të punës së administratës publike në kuptimin e problemeve racore, nacionale, etnike apo fetare të pakicave dhe krijimin e kapaciteteve për realizimin dhe përcjelljes së të drejtave;
- nxitjes së zhvillimit të atmosferës shoqërore në të cilën ndryshimet racore, nacionale apo etnike, bindjet fetare nuk paraqesin pengesë për realizimin e të drejtave njerëzore apo qytetare dhe as përbëjnë arsye për diskriminim, por vlera që burojnë nga natyra njerëzore si e tillë.